



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 383 Akti

Nr. 550 Vendimi
Tiranë, më 12.7.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Xhensila Pine

Kryesuese

Olsi Komici

Relator

Valbona Sanxhaktari

Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 12.7.2022, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Enkeleida Hoxha**, ish-gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Enkeleida Hoxha është subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe bazuar në pikën 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, zhvilloi procedurat e shpërndarjes së çështjeve me short, ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Enkeleida Hoxha do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga

komisionerët Valbona Sanxhaktari, Xhensila Pine dhe Olsi Komici. Relator i çështjes u zgjodh komisioner Olsi Komici.

3. Komisioni me datë 9.1.2020 njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, si dhe i njoftoi trupit gjykues që do të vijonte me procesin e saj administrativ të rivlerësimit. Nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe nga subjekti i rivlerësimit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016 nga subjekti i rivlerësimit janë nisur procedurat e rivlerësimit:

- a. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b. plotësimin dhe dërgimin e deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c. plotësimin dhe dërgimin e formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

6. Komisioni është vënë në dijeni të faktit publik se nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim ILD) është filluar hetim disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit Enkeleida Hoxha. Për këtë qëllim, Komisioni i është drejtuar ILD-së me shkresë zyrtare¹, në të cilën i ka kërkuar informacion në lidhje me këtë hetim disiplinor.

7. ILD-ja, me shkresën e datës 27.9.2021², ka informuar Komisionin se ndaj subjektit Enkeleida Hoxha është dërguar pranë KLGJ-së kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Enkeleida Hoxha, duke propozuar masën disiplinore “shkarkim nga detyra”.

8. KLGj-ja³ ka përcjellë vendimin nr. ***, datë 17.3.2021, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarës Enkeleida Hoxha”, duke vendosur pranimin e kërkesës së ILD-së për *shkarkimin nga detyra të magjistrates Enkeleida Hoxha, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë*.

9. KLGj-ja, bazuar në pikën 2, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vlerësuar dhe ka

¹Shkresë nr. *** prot., datë 8.9.2021, e Komisionit.

²Përgjigja nr. *** prot., datë 27.9.2021, e ILD-së.

³Përgjigja nr. *** prot., datë 17.3.2021, e KLGj-së.

pranuar kërkesën e ILD-së, pasi gjyqtari shkarkohet nga KLGj-ja kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 140, pika 2/b, përcakton në mënyrë taksative se gjyqtari shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

11. Subjekti i rivlerësimit Enkeleida Hoxha ka paraqitur ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kundër vendimit nr. ***, datë 17.3.2021, të KLGj-së⁴.

12. Bazuar në germën “f”, të pikës 1, të nenit 131 dhe në germën “i”, të pikës 1, të nenit 134, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 71 e 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Kolegji i Posaçëm i Apelit shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

13. Kolegji i Posaçëm i Apelit⁵ ka përcjellë pranë Komisionit vendimin nr. ***, datë 31.5.2022, me të cilin ka vendosur: “*Mospranimin e ankimit të magjstrates Enkeleida Hoxha, kundër vendimit nr. ***, datë 17.3.2021, të KLGJ-së për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtares Enkeleida Hoxha. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare*”.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Trupi gjykues konstaton se znj. Enkeleida Hoxha ka qenë me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

16. Në referim të germës “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera, përcaktohet se: “*Statusi i magjstratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni*”.

17. Trupi gjykues u njoh me vendimin nr. ***, datë 17.3.2021, të KLGJ-së, për shkarkimin nga detyra të subjektit Enkeleida Hoxha, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, sipas procesit të iniciuar nga ILD-ja.

18. KLGj-ja, në vendimin nr. ***, datë 17.3.2021, ndër të tjera, është shprehur: “[...] rëndësia e madhe që ka respektimi i normave ligjore nga ana e gjyqtares gjatë ushtrimit të saj. Kjo rëndësi

⁴Ankimi nr. *** prot., datë 11.5.2021, i është përcjellë Komisionit nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit me shkresën nr. *** prot., datë 6.7.2022.

⁵Shkresë nr. *** prot., datë 6.7.2022, e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

del qartë dhe nga fakti se, pikërisht, shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të këtyre normave kur kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve ose për dhënien e drejtësisë, konsiderohen si akte dhe sjellje që diskretitojnë rëndë figurën e magjistratit siç është rasti i gjyqtarës Enkeleida Hoxha, e cila nuk është e denjë për të mbajtur, më tej, funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë [...] nga sa më lart dhe përfundimisht, Këshilli arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga ILD-ja është e bazuar në ligj dhe në prova dhe se ndaj magjistrates Enkeleida Hoxha duhet të vendoset masa disiplinore ‘shkarkim nga detyra’, bazuar gërmën ‘a’, të pikës 2, të nenit 140, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 111 të ligjit ‘Për statusin’”.

Nisur nga kjo, në kushtet kur “shkarkimi nga funksioni për përgjegjësi disiplinore” përbën një nga rastet e mbarimit të statusit të magjistratit, sipas parashikimit të gërmës “ç”, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor konfirmon se znj. Enkeleida Hoxha i ka mbaruar statusin e magjistratit.

19. Pas shqyrtimit të ankimit të magjistrates Enkeleida Hoxha nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në datën 31.5.2022 është marrë vendimi nr. ***, për mospranimin e ankimit të magjistrates Enkeleida Hoxha, kundër vendimit nr. ***, datë 17.3.2021, të KLGj-së, për caktimin e masës disiplinore ndaj saj. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në fletoren zyrtare.

20. Ky vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. ***, datë 6.7.2022.

21. Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen.

22. Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar *pamundësinë në objekt apo qëllim*, ku sipas kësaj dispozite, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

23. Në zbatim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për znj. Enkeleida Hoxha, pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b, të nenit 140, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në gërmën “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Enkeleida Hoxha, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 12.7.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Xhensila PINE
Kryesuese

Olsi KOMICI
Relator

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj